



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

**RAPORTI VJETOR I VITIT 2021 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË
REALIZUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

1. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2021, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka realizuar planin e saj të konsultimit publik të akteve, duke realizuar procesin e konsultimit publik për 1 (një) projektvendim (*Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026”*), duke përmbushur në masën 100% detyrimin për konsultim publik të akteve të miratuara, objekt i Ligjit Nr. 146/2014 për “Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Procesi i konsultimit është kryer nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe aktiviteteve të tjera konsultative. Ky projektvendim është planifikuar në Planin Vjetor të Konsultimit Publik 2021.

Nga analiza e kryer pas përfundimit të konsultimeve rezulton që ka një numër të lartë të komenteve/sugjerimeve nga publiku.

Kemi marrë komente/sugjerime nga shumë palë të interesuara, të ardhura kryesisht nëpërmjet takimeve të grupeve të punës dhe komenteve/sugjerimeve të ardhura me postë. Një pjesë e këtyre komenteve/sugjerimeve janë përfshirë në procesin e vendimmarrjes, duke u integruar në tërësi në përmbajtjen e projektvendimit. Ndërkohë nga monitorimi i regjistrit elektronik të konsultimit publik, rezulton se ka ardhur vetëm një koment.

Vlerësohet se procesi, në raport me periudhën e kaluar (vitin 2020), ku pjesëmarrja e aktorëve ishte më e ulët është përmirësuar në të gjitha aspektet. Për herë të parë në RENJK është dërguar një koment nga publiku lidhur me konsultimin publik të akteve, përpos komenteve të shumta të grumbulluara në takimet e zgjeruara konsultative, ku pjesëmarrja e aktorëve të interesit ka qenë maksimale.

Nxitja e publikut për të rritur pjesëmarrjen në proceset e konsultimit publik mbetet një nga sfidat kryesore të gjithë administratës publike në drejtim të konsolidimit të konsultimit publik, si një hallkë thelbësore në zinxhirin e procesit të hartimit të legjislacionit.

Pra, gjatë vitit 2021, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka realizuar 100% planin e saj të konsultimit publik të akteve duke realizuar procesin e konsultimit publik për aktet objekt i Ligjit Nr. 146/2014 për “Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026”, i është nënshtruar një procesi kompleks dhe të zgjeruar konsultimi publik me rreth 140 aktorë dhe grupet e interesit të fushës në takime të drejtëpërdrejta dhe një masë të gjerë qytetarësh nëpërmjet platformës online të njoftimit dhe konsultimit publik.

Procesi krahasuar me vitin e mëparshëm është përmirësuar, lidhur diversifikimin e mjeteve të përdorura për konsultim, rritjen e aksesit të qytetarëve në konsultim dhe në shkallën e reaguesve të mbledhura.

Përforcimi i kulturës pjesmarrëse dhe nxitja e publikut për të rritur përfshirjen në proceset e politikbërjes publik mbetet një nga sfidat kryesore në drejtim të konsolidimit të konsultimit publik.

2. Analiza e konsultimeve të kryera gjatë vitit 2021

2.1 Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në vitin 2021?

Gjatë vitit 2021 Ministria e Arsimit dhe Sportit ka miratuar gjithsej 35 projektvendime, nga të cilat vetëm një projektvendim plotësonte kushtet për t'iu nënshtruar procesit të konsultimit publik duke qenë se ishte një akt nënligjor me interes të lartë publik. Gjatë vitit 2021 është zhvilluar konsultimi publik vetëm për (1) një projektvendim (*Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026"*), (100%).

2.1.2 Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Nga MAS është konsultuar 1 akt, konkretisht: Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026", i cili është Vendim me rëndësi strategjik dhe sipas pikës 1, të nenit 1 të ligjit "Për konsultimin publik", i nënshtrohet këtij procesi.

Ndërkohë aktet e tjera të miratuara (34 vendime) nuk hyjnë në kategorinë e projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik, për t'iu nënshtruar detyrimeve që rrjedhin nga ligji "Për konsultimin publik", por janë trajtuar me grupet e interesit të cilëve do t'u ndikonte në mënyrë të drejtëpërdrejt ose të tërthortë përmbajtja e akteve, sipas rastit.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Për këtë periudhë nuk janë konsultuar akte të cilat shoqërohen me VNR.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyt kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Në PPAP janë përjashtuar (me anë të kriterëve përjashtuese) 34 akte. (Sqarojmë se këto akte kanë qenë Akte Normative dhe Vendime të Këshillit të Ministrave, të cilat nuk kanë qenë dokumente strategjike). Nga PKIE dhe dokumentet strategjike nuk ka akte për të cilat janë aplikuar kriteret përjashtuese.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

MAS ka konsultuar 1 (një) projektvendim me rëndësi strategjike.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Situata në krahasim me vitin e kaluar është përmirësuar.

Në pocesin e konsultimit janë përfshirë një numër i gjerë aktorësh, në disa platforma si RENJK, takime konsultative, e-mail dhe sugjerimet e tyre janë reflektuar si në raportin individual të konsultimit ashtu edhe në relacionin e dërguar në Këshillin e Ministrave duke pasqyruar nëse janë pranuar ose pse jo. Në krahasim me vitin 2020, ku procesi i konsultimit publik u krye, por ka patur pak kommente nga publiku i gjerë, për vitin 2021, hapat e procesit janë respektuar rigorozisht: Projektvendimi është publikuar në sistemin e informacionit të qeverisë (RENJKP), është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit dhe janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre nëpërmjet raporteve individuale, në draftin e ri pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara.

2.2 Metodatat e konsultimit

2.2.1 *Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)*

Për të zhvilluar konsultimet publike u përdoren këto metoda:

- i. Publikimi i draftit të projektvendimit në Regjistrin Elektronik;
- ii. Njoftimi dhe Konsultimi me anë të takimeve konsultative;
- iii. Publikimi i draftit në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (të gjitha komentet/sugjerimet mund të dërgoheshin në adresën e e-mailit të hapur për këtë qëllim: (dikensa.topi@arsimi.gov.al dhe voltisa.koci@arsimi.gov.al) dhe zhvillimi i takimeve publike.

Konkretisht, për projektvendimin “(Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026”), për të cilët konsultimi publik është mbyllur, kemi bërë publikimin në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit (RENJK) <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/349> dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit: <https://arsimi.gov.al/draft-strategjia-kombetare-e-arsimit-2021-2026/> .

Për projektvendimin kemi marrë komente nëpërmjet takimeve të realizuar, komente me email dhe kërkesa me postë drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, pasi ishin njohur me projektvendimin nëpërmjet faqes zyrtare të MAS. Nga konsultimet publike të kryera më së shumti kemi marrë komente/sugjerime nga takimet e realizuara dhe me postë dhe postë elektronike (e-mail). Nisur nga ky fakt, këto metoda konsultimi rezultojnë të jetë metoda më efikase, duke pasqyruar dhe numrin më të madh të komenteve të marra, rreth 140 komente.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Njoftimi dhe Konsultimi i projektvendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026”, me anë të takimeve konsultative, konkrete me grupet e ndryshme të interesit rezultoi metoda më efiçase e konsultimit për projektaktin.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Për PVKM “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026” u bënë konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit me ministrinë anëtare, organizata të shoqërisë civile, si dhe Departamentin për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Kryeministrisë.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

Projektvendimi ka qenë i publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit (RENJK) nga data katërmëdhjetë maj 2021 deri me datën shtatë qershor 2021. Ndërkohë që janë zhvilluar takime në kuadër të konsultimit përgjatë gjithë muajit maj dhe qershor 2021.

2.3.1 Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Procesi i konsultimit për PVKM “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026” është kryer duke respektuar afatet të cilat fillojnë që nga momenti i njoftimit, kryerjes së takimeve dhe afatit të lënë për marrjen e komenteve. Konkretisht, për projektvendimin “(Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026””, për të cilët konsultimi publik është mbyllur, kemi bërë publikimin në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit (RENJK) <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/349> nga data katërmëdhjetë maj 2021 deri me datën shtatë qershor 2021 (14.05.2021-07.06.2021) dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit: <https://arsimi.gov.al/draft-strategjia-kombetare-e-arsimit-2021-2026/>.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Procesi i konsultimit për PVKM “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026” është kryer duke respektuar afatet të cilat fillojnë që nga momenti i njoftimit, kryerjes së takimeve dhe afatit të lënë për marrjen e komenteve. Konkretisht nga data katërmëdhjetë maj 2021 deri me datën shtatë qershor 2021 (14.05.2021-07.06.2021).

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Po, në proces është mundësuar pjesëmarrja e më shumë aktorëve të interesuar.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Draft-Strategjia Kombëtare për Arsimin dhe Plani i Veprimit është hartuar dhe koordinuar nga MASR (sot MAS) me kontributin e Grupit të Koordinimit ngritur me Urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 555, datë 22.11.2019, dy grupeve të punës: Grupin e Punës për Arsimin Parauniversitar dhe Grupin e Punës për Arsimin e Lartë, pesë Grupeve Tematike të cilat adresuan fushat e zotërimit të kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës në arsimin parauniversitar, mësuesit, gjithëpërfshirjen dhe barazinë në arsimin parauniversitar, menaxhimin dhe sigurimin e cilësisë dhe digjitalizimin në arsim.

Me urdhrin nr. 166, datë 10.06.2020 është ngritur edhe grupi i punës për hartimin e propozimeve në fushën e arsimit parauniversitar, në kuadër të hartimit të draft-Strategjisë Kombëtare për Arsimin.

Në këto grupe pune krahas përfaqësuesve të strukturave të ndryshme të brendshme në MAS, ka patur anëtarë nga institucione varësie të MAS, si: nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, ashtu si dhe përfaqësues nga ministri të tjera dhe nga institucione të tyre të varësisë si: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Institucionet Arsimore.

Në grupin e punës ka patur një përfaqësues edhe nga subjekti juridik “Save the Children”.

MAS është mbështetur nga UNICEF përmes një grupi ekspertësh të cilët lehtësuan punën e Grupit të Koordinimit dhe Grupeve të Punës/tematike në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik, që nga momenti i hartimit deri te kostimi dhe përgatitja e pasaportës së treguesve.

Numri i pjesëmarrësve kontribues është rreth 140 aq sa është edhe numri i komenteve të marra, ndërkohë që rreth 43 prej pjesëmarrësve kanë ndikuar në përmirësimin e draftit të strategjisë, të cilëve u janë marrë në konsideratë sugjerimet.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Si më lart, MAS është mbështetur nga UNICEF përmes një grupi ekspertësh të cilët ishin ekspertë individualë dhe që ndihmuan me ekspertizën e tyre Grupin e Koordinimit dhe Grupeve të Punës/tematike në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik, që nga momenti i hartimit deri te kostimi dhe përgatitja e pasaportës së treguesve.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

MAS në hartimine draft-Strategjisë është mbështetur nga UNICEF përmes një grupi ekspertësh të cilët lehtësuan punën e Grupit të Koordinimit dhe Grupeve të Punës/tematike në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik, që nga momenti i hartimit deri te kostimi dhe përgatitja e pasaportës së treguesve.

Gjatë procesit të konsultimit të strategjisë kanë marrë pjesë afërsisht 30 organizata, 5 ambasada të shteteve të ndryshme, përfaqësues të Këshillit të Evropës, institucioneve të arsimit të lartë, studentë, nxënës, pedagogë, mësues, punonjës psikosocial dhe oficerë sigurie. Për shkak të numrit të lartë të aktorëve të përfshirë është e vështirë të japim një numër konkret të të gjithë aktorëve pjesëmarrës.

Numri i pjesëmarrësve kontribues është rreth 140 aq sa është edhe numri i komenteve të marra ndërkohë që rreth rreth 43 prej pjesëmarrësve kanë ndikuar në përmirësimin e draftit të strategjisë, të cilëve u janë marrë në konsideratë sugjerimet.

Në këtë kuadër janë zhvilluar një sërë takimesh publike/konsultative, si vijojnë:

Në datë 14 maj 2021 u mbajt takimi me Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar në të cilin morën pjesë anëtarët e këshillit, përfaqësues të sindikatave, subjektit “Save the Children”, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, nga Ministri i Shtetit për Diasporën.

Në datë 20 maj 2021 u mbajt në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit takimi me Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor ku morën pjesë fizikisht, por dhe online përfaqësuesit e këtij këshilli.

Në vijim të procesit të Konsulimit Publik u mbajtën takime konsultative me 4 Drejtoritë Rajonale të Arsimit Pauniversitar (DRAP) përkatësisht, 21 maj 2021 DRAP Durrës, 24 maj 2021 DRAP Fier, 28 maj 2021 DRAP Korçë, 31 maj 2021 DRAP Lezhë. Në këto takime morën pjesë, përfaqësues të njësisë të vetëqeverisjes vendore, prindër, mësues, drejtues shkollash, nxënës, punonjës psikosocial, oficerë sigurie etj.

Në datë 27 maj 2021 u zhvillua takimi me Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) publike dhe jopublike në Shqipëri.

Në datë 31 maj 2021 u zhvillua takim me Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik të Kuvendit të Shqipërisë ku u diskutua mbi sugjerime dhe propozime të vlefshme mbi vijimin e reformave në arsim si dhe hartimin e një strategjie sa më gjithëpërfshirëse dhe me një ndikim të drejtpërdrejtë në ritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Në datë 1 qershor 2021 u zhvillua takimi me Grupin Ndërinstitucional të Punës të kapitullit 26 në të cilin morën pjesë anëtarët e grupit të punës. Gjithashtu po në datë 1 qershor 2021 u zhvillua në ambientet e MASR një takim më nxënës ku morën pjesë dhe drejtuesi i UNICEF në Shqipëri, si dhe Krye Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në datë 2 qershor u mbajt takimi me Shoqërinë civile në të cilin morën pjesë përfaqësues të shoqatave të ndryshme, OJQ dhe aktorë të ndërlidhur me fushën e arsimit.

Në datë 4 qershor u mbajt takimi me Grupin Tematik të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) ku morën pjesë përfaqësues nga Kryeministria, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, MFE etj.

Në datë 11 qershor 2021 u mbajt takimi me Donatorët ku morën pjesë përfaqësues të njësive diplomatike në Shqipëri si: Ambasada Gjermane, Ambasada Franceze, Ambasada Italiane, Ambasada e Kosovës, Ambasada e Spanjës, Këshilli i Evropës, British Council, OSCE, Save the Children, UNICEF, Agjencia Austriake për Arsim etj.

Pas përmbylljes së këtij procesi të gjerë konsultativ u mblodhën të gjithë komentet e ardhura, sugjerimet të cilat u vlerësuan nga grupet përkatëse të punës/tematike të ngritur me urdhër Ministri.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Kontribuesit që morën pjesë në konsultimet publike lidhur me dhënien e mendimeve/ sugjerimeve/ rekomandimeve për hartimin e Draft-Strategjisë Kombëtare për Arsimin janë: Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALKSH), Bashkia Durrës, Prefektura Qarku Durrës, DPAP, DRAP Durrës, ZVA Durrës, ZVA Tiranë, ZVA Kavajë, ZVA Mat, ZVA Bulqizë, ZVA Rrogozhinë, ZVA Klos, UAMD, Drejtues/punonjës të SHPS në institucionet e arsimit të mesëm, Nxënës, Prindër, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar Fier, Zyra Arsimore Fier, ZVAP Lushnje, ZVAP Tepelenë, ZVAP Sarandë, ZVAP Përmet-Këlcyrë, ZVAP Divjakë, ZVAP Vlorë-Himarë, ZVAP Selenicë, ZVAP Patos, ZVAP Roskovec, ZVAP Mallakstër, ZVAP Finiq-Dropull, Bashkia Vlorë, Bashkia Lushnje, Prefektura Fier, Shkolla 9 vjecare “Liri Gero”, Shkolla 9 vjecare “M.Gosnishti”, Gjimnazi “Ali Demi”, Shkolla “D.Hekali”, Gjimnazi “18 Tetori”, Shkolla “L.Libohova”, shkolla “Lef Sallata”, Shkolla “Lili Starre”, Gjimnazi “Janaq Kilica”, Gjimnazi “Jakov Xoxa” Shkolla “Mit Zoi Zaka”, Gjimnazi “Zhani Ciko”, Shkolla “Jani Bakalli”, Gjimnazi “Perikli Ikonomi”, ZVAP Vau Dejës; DRAP Lezhë; ZVAP Mirditë; ZVAP Shkodër; Prefekti Qarku Lezhë; Prefekti Qarku Shkodër; ZVAP Kukës; Bashkia Mirditë; ZVAP Has; ZVA Tropojë; ZVA Malësi e Madhe; Përfaqësues Gjimnazi “Sherif Hoxha”; Drejtori “Hydajet Lezha”; Drejtori Gjimnazi Rrëshen; Kryetare/Përfaqësues të Këshillit Rajonal të prindërve DRAP “Lezhë”; ZVAP “Kurbini”; Bashkia “Kukës”; Bashkia “Tropojë”; “Kukës”; ZVAP “Pukë”; Përfaqësues të Nxënësve nga gjimnazet “Hydajet Lezha”; “28 Nëntori”; “Milot”; “Shaban Sinani”; “Ismet Luçjan Augustin”; Specialist DRAP “Lezhë”, përfaqësues nga DRAP Korçë, përfaqësues të pushtetit vendor (Kryetari Bashkisë Korçë/Maliq/Nënkryetare Bashkisë Korçë), drejtorë/nënpunës të Zyrave Vendore Arsimore, përfaqësues të prefekturës, drejtorë shkollash, mësues, Komiteti për Pakicat Kombëtare, IRCA, Terre des Hommes, Organizata “Fëmijët Janë e Ardhmja”, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjëve”, UNICEF, Koalicioni i Arsimit, Save the Children, World Vision, Kongresi Rinor Kombëtar, Junior Achievement of Albania, Shoqata për Autonomi Vendore, KKEKSH, MEDPAK, Qendra për Arsim Cilësor, Shkolla e Drejtorëve, Ambasada Franceze, UET, British Council - Qendra CVE (Kryeministria), Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Qendra “Maria Mazzarello”, Tiranë përfaqësues nga British Council, Këshilli i Evropës, Agjencia Austriake për Arsim, OSCE dhe

AADF.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Po, janë përfshirë më shumë aktorë, sidomos anëtarë të organizatave të shoqërisë civile. Ndërkohë formatet për përgatitjen e akteve kanë kërkuar një punë më të specializuar prandaj janë përfshirë përveçse institucioneve shtetërore edhe ekspertë individual të fushës.

2.5 Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Gjatë konsultimit të strategjisë është vënë re angazhimi i palëve të interesuara për të kontribuar në përmirësimin e draftit të strategjisë dhe adresimit të problematika në fushën e arsimit. Janë marrë rreth 141 komente nga të gjitha metodat e konsultimit.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Komentet e marra janë vlerësuar nga ekspertët dhe si konkluzion 27 prej tyre janë pranuar plotësisht, 16 prej tyre janë pranuar pjesërisht dhe 97 prej tyre janë refuzuar.

2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Në konsultim janë përfshirë më shumë aktorë, sidomos anëtarë të organizatave të shoqërisë civile. Gjithashtu, është përdorur edhe RENjK për të dhënë komente të vlefshme, gjë që në vitet e tjera nuk ka ndodhur.

2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Akti nuk duhej të pajisej me raport VNR, në bazë të legjislacionit në fuqi.

2.6 Rezultatet e raporteve të konsultimeve

2.6.1 Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Komentet e marra janë vlerësuar nga ekspertët dhe si konkluzion 27 prej tyre janë pranuar plotësisht, 16 prej tyre janë pranuar pjesërisht dhe 97 prej tyre janë refuzuar. Përsa u përket komenteve të refuzuara vlen të përmendim se shumica prej tyre janë refuzuar duke qenë se kanë qenë pjesë e draftit të strategjisë prandaj nuk ka lindur nevoja të reflektohen sërish ndërsa pjesa tjetër përgjithsisht ishin rekomandime specifike që nuk lidheshin me strategjinë.

Raporti i Konsultimit është publikuar në sistemin e-aktet dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit <https://arsimi.gov.al/projektvendimi-per-miratimin-e-strategjise-kombetare-per-arsimin-2021-2026/> .

2.6.2 Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Raporti i konsultimit është publikuar.

2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik

Si konkluzion konstatojmë se procesi i konsultimit të këtij projektakti ka rezultuar i sukseshëm dhe komentet e marra kanë shërbyer në përmirësimin e draftit të strategjisë, ndaj mendojmë numrin 8.

3 Sfidat, rreziqet kryesore dhe mundësitë për të ardhmen

Sfida kryesore mbetet nxitja e publikut për të rritur pjesëmarrjen në proceset e konsultimit publik. Për të bërë të mundur rritjen e pjesëmarrjes së publikut, nëpërmjet dhënies së mendimeve/sugjerimeve kërkohet angazhimi i të gjitha institucioneve shtetërore, të përfshira në procesin e konsultimit.